



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 528/25 Dt. 05.09.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e transportit të nxënësve udhëtar mbi 4 km largësi nga shkollat, për vitin shkollor 2025/2026, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për transportin (bartjen) e nxënësve udhëtar të disa shkollave fillore të Komunës së Prizrenit, në relacionin:
 - 1.1. Dobrushtë-Vermicë dhe anasjelltas, për kl. VI-IX, të SHFMU “Heronjë e Lumës”;
 - 1.2. Myradem-Vlashnje dhe anasjelltas, për kl. I-IX, të SHFMU “Naim Frashëri”;
 - 1.3. Tupec-Gjonaj dhe anasjelltas, për kl. VI-IX, të SHFMU “Zenun Çoçaj”;
 - 1.4. Gorozhup-Planejë dhe anasjelltas, për kl. VI-IX, SHFMU “Vëllezërit Frashëri”;
 - 1.5. Drajqiç-Mushnikovë dhe anasjelltas, për kl. I-IX, të SHFMU “Mushnikova”;
 - 1.6. Gornjesell-Mushnikovë dhe anasjelltas për nx. në gjuhën shqipe në SHFMU “Mushnikova”;
 - 1.7. Llokvic-Reqanë dhe anasjelltas, për kl. VI-IX, të SHFMU “Meto Bajraktari”;
 - 1.8. Gornjesell-Reqanë dhe anasjelltas, për kl. VI-IX, të SHFMU “Meto Bajraktari”.
 2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor–mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.
 3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj